Albanian

Rruga Webster, Dandenong, tetor 2026

Përshëndete veprën e re artistike të Dandenong-ut

LEVEL CROSSING REMOVAL PROJECT

Vepra artistike e pikturuar me dorë nga Angharad Neal-Williams është shtesa më e re në Rezervatin Woodcock dhe në të gjithë Dandenong.

E vendosur përgjatë shtegut të ecjes dhe çiklizmit nën urën hekurudhore në Rezervatin Woodcock, *Ways of Wandering* (Mënyrat e endjes) është një mural që feston mënyrat se si hapësirat e gjelbra dhe mjedisi natyror afrojnë komunitetet.

Duke punuar me komunitetin e Dandenong-ut për të eksploruar tema të natyrës, bashkësisë dhe komunitetit, veprat artistike të z. Angharad pasqyrojnë mënyrën se si hapësirat e gjelbra na lidhin me natyrën dhe njëri-tjetrin.

Dizajnet janë frymëzuan nga workshop-et e organizuara me komunitetin lokal në Shkollën fillore Dandenong South, bazarin e Dandenong-ut dhe Bibliotekën e Dandenong-ut, duke e mbushur muralin me ngjyra dhe jetë, me bimët, lulet dhe zogjtë që mund të gjenden në Përroin Dandenong, Parkun Dandenong dhe rrethinat e Rezervatit Woodcock. Skenat e tubimeve dhe lojërave lokale shtojnë ndjenjën e bashkimit, duke pasqyruar lidhjen midis komunitetit dhe natyrës.

Veprat artistike të pikturuara me dorë nga z. Angharad Neal-Williams shfaqen gjithashtu në kutitë e sinjalizimit dhe kabinetet elektrike në kryqëzimin e rrugëve Dow Court me Princes Highway–Lonsdale, si edhe në kryqëzimin e rrugëve Cheltenham me Hammond.

Frymëzuar nga temat e eksploruara në vizatimet e nxënësve të Shkollës fillore Dandenong South, këto vepra artistike përshkruajnë mënyrat se si komuniteti lokal lëviz nëpër zonë dhe paraqet skenat e lëvizjes së qetë, tranzicionit, endjes dhe kohës së kaluar me të tjerët.

"Kombinimi i elementeve në veprën artistike krijon një dizajn të ngrohtë dhe të qetë që gëzon një ndjenjë loje, bashkësie, gëzimi dhe mrekullie, të gjitha të ngulitura në natyrë dhe komunitet" - tha Angharad.

"Shpresoj që të gjithë ta shohin veten në këtë vepër artistike, ose të kenë një ndjenjë familjariteti me personazhet e dizajnit".

Njihuni me artistin – Angharad Neal-Williams

Angharad Neal-Williams është një ilustrues që jeton në Melburn.

Duke u frymëzuar nga takimet dhe vëzhgimet e përditshme, ilustrimet e z. Angharad festojnë momente të vogla mrekullie në gjërat e zakonshme, gëzim në familjaritet dhe lojë në jetën e përditshme.

Për të parë më shumë vepra artistike të z. Angharad Neal-Williams, vizitoni **www.angharad.au**



Murali "Ways of Wandering" (Mënyrat e endjes) nën urën hekurudhore në Rezervatin Woodcock, Dandenong.

levelcrossings.vic.gov.au

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)

levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au

Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.

Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni **relayservice.gov.au**

VICTORIA'S BIG BUILD

VICTORIA State Government

NWP13180